



REPUBLICA E KOSOVES  
PRISHTINA  
01-2460

	<p style="text-align: center;"><b>Republika e Kosovës</b> Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;"><b>Komuna e Prishtinës</b> Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-298705/19 dt. 09.12.2019, të investitorit “Hib Petrol” Sh.p.k. me seli në Ferizaj, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810662834, me përfaqësues të autorizuar Visar Bytyqi nga Lipjani, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, të kompleksit të ndërtesave afariste me karakter të përkohshëm, me destinim-Pikë e shitjes së derivateve të naftës, restorant & market, autolarje me etazitet P+0, në rrugën “Mitrovica”, fshati Shkabaj, konkretisht në parcelën nr. 00196-0, Zona Kadastrale Orloviq, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 07.07.2021 lëshon këtë:

### CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LËSHOHET** Certifikata e përdorimit pronarit/investitorit “Hib Petrol” Sh.P.K. me seli në Ferizaj, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810662834, me përfaqësues të autorizuar Visar Bytyqi nga Lipjani, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-298705/19 dt. 09.12.2019, për përdorimin e kompleksit të ndërtesave afariste me karakter të përkohshëm me destinim-Pikë e shitjes së derivateve të naftës, restorant & market, autolarje, me etazhitet P+0 në kuadër të parcelës 00196-0, Zona Kadastrale Orloviq, sipas Vendimit 05 nr.351/02-0083386/17 dt. 22.05.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesave, Vendimit mbi plotësim/ndryshimit të Vendimit të Lejes Ndërtimore me nr. 05 nr.351/02-0083386/17 dt. 20.09.2017, dhe Vendimit të plotësim/ndryshimit 05 nr.351/02-0083386/17/1 dt. 16.01.2018.

**II.** Ndërtesa, mund të përdoret, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit 05 nr.351/02-0083386/17 dt. 22.05.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesave, Vendimit mbi plotësim/ndryshimit të Vendimit të Lejes Ndërtimore me nr. 05 nr.351/02-0083386/17 dt. 20.09.2017, dhe Vendimit të plotësim/ndryshimit 05 nr.351/02-0083386/17/1 dt. 16.01.2018, dokumentacionit ndërtimor dhe Njoftimin e Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

**III.** Ndërtesa mund të përdoret nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate.

**IV.** Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përkohshëm në pikën I. të këtij vendimi.

**V.** Në regjistrin Kadastral objekti të shënohet me vërejtje sepse i njëjti është i karakterit të përkohshëm.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

## Ar sy e t i m

Pronari/investitori "Hib Petrol" Sh.P.K. me seli në Ferizaj, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810662834, me përfaqësues të autorizuar Visar Bytyqi nga Lipjani, më kërkesën me 05 Nr.391/02-298705/19 dt. 09.12.2019, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për përdorimin e kompleksit të ndërtesave afariste me karakter të përkohshëm me destinim-Pikë e shitjes së derivateve të naftës, restorant & market, autolarje, me etazhitet P+0, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certifikate.

Paraprakisht Drejtoria e Inspektionit-Sektori i ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare "Njoftim mbi inspektimin final me referencë 09 Nr. 354/02-185490/19 dt. 18.01.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektionit final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e udhëzimit administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektionit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f

- Vendimin nr. 05Nr.351/02-0083386/17 dt. 22.05.2017 për lejimin e ndërtimit kompleksit të ndërtesave afariste me karakter të përkohshëm me destinim-Pikë e shitjes së derivateve të naftës, restorant & market, autolarje, me etazhitet P+0, të Pronarit/investitorit "Hib Petrol" Sh.P.K. nga me certifikatë të regjistrimit ARBK 810662834, me përfaqësues të autorizuar Visar Bytyqi nga Lipjani, e ndërtuar në kuadër të parcelës nr. 196-0, Zona Kadastrale Orloviq.
- Vendimin me 05 nr.351/02-0083386/17 dt. 20.09.2017 mbi plotësim/ndryshimit të Vendimit të Lejes Ndërtimore me 51/02-0083386/17 dt. 22.05.2017,
- Vendimin me 05 nr.351/02-0083386/17/1 dt. 16.01.2018. mbi plotësim/ndryshimit të Vendimit të Lejes Ndërtimore me 51/02-0083386/17 dt. 22.05.2017, dhe Vendimit mbi plotësimin e vendimit 05 nr.351/02-0083386/17 dt. 20.09.2017.
- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Aktvendimin me nr. 05 Nr. 351/02-0083386/17 dt. 25.04.2017, mbi caktimin e taksës administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Informim mbi caktimin e adresës për objektin me nr. të referencës 05-015/02-0261617/18 dt. 05.11.2018, Rr. "Mitrovica".
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Fatos Hajdini, IDE. Ideal Vejsa. mbikëqyrës për arkitekturë, Memli Dushi IND. mbikëqyrës për Strukturë, Arban Shala, IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime, Fatos Hajdini, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike, Lulzim Kryeziu, IDM. Mbikëqyrës për Instalime makinerike, Shaban Halili, mbikëqyrës për instalimet për mbrojtje nga zjarri, Fatmir Ademi, gjeodet me nr të licencës 70.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektionit Final të ndërtimit të ndërtesës nga Inspektioni me

referencë 09 Nr. 391/02-185490/19 dt. 18.01.2021, dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-298705/19 dt. 09.12.2019 dhe plotësimit të dokumentacionit 05 Nr. 391/02-298705/19/1 dt. 02.03.2021 ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimeve makinerike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zejtare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05nr.351/02-0083386/17 dt. 22.05.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesave, Vendimit mbi plotësim/ndryshimit të Vendimit të Lejes Ndërtimore me nr. 05 nr.351/02-0083386/17 dt. 20.09.2017, dhe Vendimit të plotësim/ndryshimit 05 nr.351/02-0083386/17/1 dt. 16.01.2018. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm, mund të përdoret.

Njëkohësisht nga Drejtoria e Inspektionit-Spektori i Ndërtimit përmes shkresës nr. 09 Nr.391/02-185490/19 dt. 18.01.2021 ka arritur në Drejtori: Formulari i Inspektimit Final sipas UA. 05/2017 i plotësuar nga Drejtoria përkatëse, Raporti Final i inspektorëve, njoftim për punët e kryera në objekt si dhe foto të objektit të realizuar. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Mbikëqyrjes Profesionale të angazhuar nga ana e Poseduesit të Lejes Ndërtimore.

**Kërkesat e Vendimit Lejes Ndërtimore janë zbatuar,**

**Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,**

**Masat për kursim të energjisë janë zbatuar.**

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që kompleksi i ndërtesave afariste me karakter të përkohshëm me destinim-Pikë e shitjes së derivateve të naftës, restaurant & market, autolarje, me etazhitet P+0, mund të përdoren/shfrytëzohen, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këto ndërtesa.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certifikate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 391/02-298705/19 DT. 07.07.2021**

Zyrtari:

Berim Osmanaj

U.D. Udhëheqëse e sektorit

Mimoza Berisha Prestreshi

Faqe 3 prej 3

Drejtori:

Ardian Ollari



Komuna e Prishtinës  
Drejtorija e Urbanizmit

Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 383 (0) 38 221 242  
e-mail: urbanizmi@prishine.gov.net

